

NDËRLIDHJA NË MES TË STILEVE TË PRINDËRIMIT, VETË-EFIKASITETIT PËR  
KARRIERË DHE VENDIMMARRJES PËR KARRIERË TEK TË RINJTË KOSOVAR

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

LEJLA HOXHAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

PRISHTINË

QERSHOR, 2024

Ndërlidhja në mes të stileve të prindërimit, vetë-efikasitetit për karrierë dhe vendimmarrjes për karrierë tek të rinjtë Kosovar

Lejla Hoxhaj

Mentori: Liridona Jemini – Gashi, Prof. Asoc. Dr.

Ky studim ka për qëllim të hulumtojë marrëdhënien mes stileve të prindërimit (stili autoritarian, autoritativ dhe premisiv/lejues) dhe vetë-efikasitetit në vendimmarrjen e adoleshentëve për karrierë, poashtu ka për qëllim të hulumtojë mbi ndikimin e stileve të prindërimit në vetë-efikasitetin e vendimmarrjes së adoleshentëve për karrierë. Përveq këtyre, ky hulumtim mbi stilet e prindërimit dhe vetë-efikasitetin për vendimmarjen në karrierë mund të jetë shumëdimensional dhe të përfshijë disa objektiva të rëndësishëm si: identifikimi i faktorëve specifikë të stileve të prindërimit dhe vetë-efikasitetit që kanë ndikim më të fortë në procesin e vendimmarjes, ngritja e vetëdijes ndër individë rreth ndikimit të stileve të prindërimit dhe vetë-efikasitetit në vendimarrjen për karrierën dhe përmirësimi i aftësive për të qenë të pajtuar me vendimet e tyre. Të gjeturat nga ky hulumtim mund të ndihmojnë në zhvillimin e programave mbështetëse, edukative dhe këshilluese për karrierë që përfshijnë prindërit dhe adoleshentët. Poashtu, hulumtimi mund të ofrojë informacione që mund të ndikojnë në politikat dhe sistemet edukative.

Ky studim shqyrton lidhjen mes stileve të ndryshme të prindërimit dhe ndikimin e tyre në sigurinë dhe pavendosmërinë e adoleshentëve për karrierën. Për të realizuar qëllimet e hulumtimit janë shtruar pyetjet dhe hipotezat se a ekzistojnë dallime në këto aspekte mes adoleshentëve me stile të ndryshme prindërimi, duke propozuar se ekzistojnë dallime të tilla. Gjithashtu, shqyrtohet ndërlidhja mes stileve të prindërimit dhe sigurisë për karrierë, duke sugjeruar se stili autoritativ ka ndërlidhje pozitive, ndërsa stili autoritarian dhe autoritativ kanë ndërlidhje negative me këtë siguri. Në të njëjtën kohë, studimi shqyrton ndërlidhjen mes stileve të prindërimit dhe pavendosmërisë për karrierë, duke sugjeruar se stili autoritativ ka ndërlidhje negative, ndërsa stili autoritarian dhe autoritativ kanë ndërlidhje pozitive me pavendosmërinë. Për më tepër, studimi sugjeron se ekzistojnë ndërlidhje të rëndësishme mes stileve të prindërimit dhe vetë-efikasitetit për karrierë, si dhe mes vetë-efikasitetit për karrierë dhe sigurisë ose pavendosmërisë për karrierë. Së fundmi,

studimi propozon se vetë-efikasiteti luan rol ndërmjetësues në marrëdhënien mes stileve të prindërimit dhe sigurisë ose pavendosmërisë për karrierë.

Ky studim korrelacional me qëllim për të kuptuar më mirë marrëdhënien mes stileve të prindërimit dhe vetë-efikasitetit për vendimmarrjen e adoleshentëve në karrierë ndjek dizajnin ndërsektorial dhe ndjek metodën kuantitative. Variablat që do të matën në këtë studim janë: Stilet e prindërimit si variabël e pavarur dhe vendimmarrja e adoleshentëve për karrierë si variabël e varur, ndërkaq vetë-efikasiteti për karrierë si variabël ndërmjetësuese. Vlerësimi i stileve të prindërimit do të bëhet me pyetësorin e autoritetit prindëror, Parental Authority Questionnaire – PAQ nga Buri (1991), për të matur vetë-efikasitetin për vendimmarrjen në karrierë do të aplikohet pyetësori CDMES (Career Decision-Making Self-Efficacy) nga Taylor dhe Betz (1983), ndërsa për të matur vendimmarrjen për karrierë (sigurinë dhe pavendosmërinë për karrierë) do të përdoret pyetësori “Shkalla e vendimmarrjes për karrierë” (CDS- Career Decision Scale) nga Osipow dhe kolegëve (1976). Pjesëmarrës në hulumtim ishin gjithësej 208 të rinjë kosovarë (N = 208), 50.5% prej tyre vijonin shkollë të mesme gjimnaze dhe 49.5% vijonin shkollë të mesme profesionale. Moshë e pjesëmarrësve varionte nga 16 vjeç deri në 19 vjeç, ku moshë mesatare ishte 17.51 vjeç (M=17.51, SD=.621), ndërkaq shumica e pjesëmarrësve i takonte grupmoshës 18 vjeçare (49%) duke u pasuar nga grupmosha 17 vjeçare (46.6%). Shumica e pjesëmarrësve i takonin gjinisë femërore (61.5%), përkatësisht 128 femra, 78 meshkuj (37.5%) dhe 2 pjesëmarrës kanë deklaruar me “tjetër” (1%). Për sa i përket vendbanimit të pjesëmarrësve, 136 prej tyre kanë deklaruar se banojnë në zona urbane (65.4%), dhe 72 prej tyre kanë deklaruar se banojnë në zona rurale (34.6%).

Analiza e rezultateve të hulumtimit tregon një lidhje të rëndësishme midis stileve të ndryshme të prindërimit dhe sigurisë/pavendosmërisë për vendimmarrje në karrierë te adoleshentët. Në përgjithësi, kërkimi i kryer ka zbuluar se ekzistojnë dallime në nivelin e sigurisë dhe pavendosmërisë për karrierë në lidhje me stilet e ndryshme të prindërimit. Në veçanti, analizat statistikore tregojnë se stili autoritativ ka një ndikim pozitiv në sigurinë për vendimmarrje në karrierë, ndërsa stili autoritarian dhe lejues kanë një ndikim pozitiv në pavendosmërinë për karrierë. Këto gjetje sugjerojnë se mënyra se si prindërit trajtojnë adoleshentët e tyre ka një ndikim të qëndrueshëm në perceptimin e tyre për sigurinë dhe pasigurinë në lidhje me vendimmarrjen për karrierë. Analizat e ndërlidhjes midis stileve të prindërimit dhe vetë-efikasitetit për karrierë

gjithashtu ofrojnë informacion të rëndësishëm. Për shembull, stili autoritativ parashikon një vetë-efikasitet më të lartë për vendimmarrje në karrierë, ndërsa stili autoritarian dhe lejues nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në vetë-efikasitetin për karrierë. Në përfundim, këto rezultate përforcojnë rëndësinë e rolit të stileve të prindërimit në formimin e sigurisë dhe pavendosmërisë së adoleshentëve në lidhje me vendimmarrjen për karrierë. Kuptimi i këtyre ndikimeve mund të ndihmojë në zhvillimin e strategjive dhe ndërhyrjeve për të përmirësuar besimin dhe sigurinë e adoleshentëve në procesin e vendimmarrjes për karrierë në të ardhmen.